



## Epiduralet në dhimbjet e lindjes - çfarë duhet të dini

Kjo është një përmbledhje. Informacion më të plotë gjeni në seksionin [Lehtësimi i dhimbjeve gjatë dhimbjeve të lindjes](#). Ju lutemi diskutoni me anestezistin tuaj çdo gjë të paqartë.

### Përgatitja e epidurales tuaj

- Do t'ju duhet të keni vigan intravenoz dhe ndoshta serum.
- Ndërsa po ju bëhet epiduralja, është e rëndësishme që të rrini e qetë dhe të bëni të ditur anestezistin nëse keni kontraksione.
- Zakonisht duhen 20 minuta për ta vënë dhe 20 minuta që të funksionojë.
- Disa epidurale nuk funksionojnë plotësisht dhe duhet të rregullohen ose zëvendësohen.

### Përparësitë e një epiduraleje

- Zakonisht lehtëson shumë mirë dhimbjen.
- Ndonjëherë, për efekt më të shpejtë bëhet spinalja.
- Doza ose lloji i anestezisë së pjesshme ndonjëherë mund të ndryshohet për t'ju lejuar të lëvizni rreth shtratit. Kjo është dozë epiduralee ulët (ose epidurale lëvizëse).
- Në përgjithësi epiduralet nuk ndikojnë te foshnja juaj.
- Mund të rimbushet për ndërhyrjen kirurgjikale nëse kërkohet.

### Probleme të mundshme me epiduralen tuaj

- Mbushjet e përsëritura me anestetik lokal më të fortë mund të shkaktojnë dobësi të përkohshme të këmbëve dhe të rrisin rrezikun e lindjes me forceps ose ventuzë.
- Epiduralja mund të ngadalësojë pak fazën e dytë të dhimbjeve të lindjes.
- Mund t'ju ulet tensioni, mund të keni krëvarje ose ethe gjatë epidurales.
- Zona epidurale mund të jetë e butë, por zakonisht vetëm për pak ditë. Dhimbja e shpinës NUK shkaktohet nga epiduralet por është e zakonshme pas çdo shtatzënie.

## Rreziku i të pasurit një epidurale ose spinale për të ulur dhimbjet e lindjes

Lloji i rrezikut	Sa shpesh ndodh kjo?	Sa e zakonshme është?
Rënie domethënëse e presionit të gjakut	Një në 50 gra	Me raste
Nuk funksionon mirë për të ulur dhimbjet e lindjes, kështu ju nevojitet të përdorni mënyra të tjera për të ulur dhimbjen	Një në 8 gra	E zakonshme
Nuk funksionon aq mirë për një operacion, kështu ju duhet t'i nënshtroheni anestezisë së përgjithshme	Një në 20 gra	Ndonjëherë
Dhimbje të forta koke	Një në 100 gra (me epidurale) Një në 500 gra (me spinale)	Të pazakonta
Dëmtim nervi (një zonë e mpirë në këmbë ose shputë ose dobësi në këmbë)	I përkohshëm - një në 1000 gra	Rrallë
Efektet zgjasin për më shumë se 6 muaj	E përhershme - një në 13 000 gra	Rrallë
Absesi epidural (infeksion)	Një në 50 000 gra	Shumë i rrallë
Meningjiti	Një në 100 000 gra	Shumë i rrallë
Hematoma epidurale (mpiksja e gjakut)	Një në 170 000 gra	Shumë e rrallë
Lëndim i rëndë, përfshirë paralizën	Një në 250 000 gra	Jashtëzakonisht i rrallë

Informacioni i disponueshëm në dokumentet e botuara nuk jep shifra të sakta për të gjitha këto rreziqe. Shifrat e treguara më sipër janë vlerësime dhe mund të jenë të ndryshme në spitale të ndryshme.